

Raport nga takimi i tretë i Grupit punues për vetëqeverisje (GPVQ)

22-24 tetor 2013, Shkup

Sfondi

Në takimin e parë të Grupit punues për vetëqeverisje, qeveritë lokale që marrin pjesë në projektin "Praktikat më të mira për integrimin e romëve" identifikuan mbledhjen e të dhënave dhe monitorimin e politikave si një nga temat kyçe për shkëmbim rajonal. Ky takim u përpoq t'i adresonte këto çështje të gjera duke u përqendruar në praktikat më të mira të komunave të Shtipit dhe Prilepit të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe duke përdorur njëherazi sistemet kombëtare të mbledhjes së të dhënave. Vëmendje e veçantë iu kushtua punës së hulumtuesve romë nga Ballkani Perëndimor, të cilët i prezantuan studimet e tyre rreth hendekut në mes të politikave dhe zbatimit të tyre.

Pjesëmarrësit

Në takim ishin të pranishme 23 komuna, të përfaqësuara nga afërsisht 30 nëpunës civilë. Nëpunësit civilë që nuk i përkitnin komunitetit rom shpesh ishin të shoqëruar nga koordinatori rom, duke i përforcuar kështu njohuritë dhe raportet e tyre. Rreth 18 OJQ kishin dërguar nga një përfaqësues, ndërsa nga ministritë për të drejtat e njeriut dhe pakica dhe entet statistikore ishin të pranishëm përkatësisht 11 dhe 3 përfaqësues. Në takim ishin të pranishëm gjithsej 97 pjesëmarrës nga rajoni i Ballkanit Perëndimor.

Shënime

1. Sistemet kombëtare të mbledhjes së të dhënave dhe të monitorimit të politikave

- Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - *"Avokimi i bazuar në fakte: Gjetjet e sondazhit mbarëkombëtar të ekonomive familjare rreth perceptimeve të romëve mbi diskriminimin"* – prezantuar nga Marijan Ponjaviq, Këshilltar shtetëror, Zyra e Avokatit të Popullit

Gjithsej 1,200 persona janë intervistuar në komunat e Kumanovës, Prilepit, Shtipit, Shuto Orizarit, Tetovës dhe Gostivarit. Pjesa më e madhe (79%) e romëve etnikë të anketuar kanë deklaruar se ata vet ose një anëtar i afërt i familjes së tyre, një mik apo kolegë kanë qenë subjekt i diskriminimit. Shumica e të anketuarve të cilët kanë qenë subjekt i diskriminimit jetojnë në komunën e Shuto Orizarit (96%), dhe shumë syresh punojnë në sektorin privat (88%). Është interesante se perceptimi i diskriminimit ndryshon në varësi të përkatësisë fetare të të anketuarve. Kështu, 58% e të anketuarve të krishterë besojnë se diskriminimi në bazë të statusit personal apo social ose shoqëror ndodh shpesh ose shumë shpesh, ndërkaq vetëm 30% e të anketuarve myslimanë pajtohen me këtë deklaratë. Ndryshim të theksuar në përqindjen e diskriminimit ka pasur edhe ndërmjet Kumanovës e Tetovës (mjaft e lartë) dhe Prilepit e Shtipit (mjaft e ulët). Arsyeja pse ndodh kjo duhet të shqyrtohet dhe të përfshihet në studim.

- "2015-ta po afron: Përcjellja e rezultateve të Dekadës për përfshirjen e romëve"* – prezantuar nga Orhan Usein, Koordinator i programit, Sekretariati i Fondacionit "Dekada e përfshirjes së romëve"

Të gjitha qeveritë pjesëmarrëse janë të obliguara që të dorëzojnë raporte të progresit që publikohen në faqen e internetit të Sekretariatit. Së fundmi, edhe shoqëria civile ka filluar që të dorëzojë raporte të progresit, dhe është interesante të krahasohen raportet e qeverive dhe shoqërisë civile. Personat për kontakt në kuadër të dekadës së romëve gjithashtu luajnë një rol kyç në informimin e Sekretariatit rreth zhvillimeve të fundit në këtë fushë.

Në rrethana ideale, të gjitha të dhënat e mbledhura do të duhej të vlerësoheshin nga ana e një komisioni dhe mundësisht të përcilleshin me një vizitë në shtetin gjegjës. Pas dialogut me shoqërinë civile, komisioni duhet t'i japë rekomandime qeverisë. Aktualisht, Dekada romë ka një kornizë të


mangët të monitorimit (platforma për BE-në përballet me problem të ngjashëm), sepse nuk ka komision vlerësimi dhe nuk ka hapësirë për raporte zyrtare në hije.

Përveç kësaj, nisma "Inteligenca e dekadës" synon që t'i mbledhë praktikatat e mira dhe të këqija dhe t'i publikojë këto informata në internet (<http://romadecade.org/about-the-decade-decade-good-practices>). Pikë jepen për aspekte të ndryshme të projektit, duke përfshirë këtu edhe kontributin në zvogëlimin e hendekut mes romëve dhe atyre që nuk janë romë. Për secilin shtet do të vlerësohen nga pesë projekte (përmes intervistave me përfituesit, akterët dhe zbatuesit) - të paktën nga një projekt për secilën fushë me përparësi dhe ata do të përqendrohen për të zgjedhur projektin "më të dobët" dhe "më të mirë". Kjo do të thotë se do të publikohen raporte vlerësimi për 60 projekte.

- Sllovakia – "Atlasi i komuniteteve rome" – prezantuar nga Jaroslav Kling, Qendra Rajonale e UNDP-së në Bratisllavë

Kjo detyrë ka synuar sigurimin e informacionit në nivel të komuniteteve rome (e jo të individëve, siç ka ndodhur në Bosnjë dhe Hercegovinë). Përmes bashkëpunimit me OJQ-të rome dhe partnerët tjerë vendorë, projekti ka synuar të mbledhë të dhëna më të sakta lidhur me karakteristikat e ndryshme të vendbanimeve dhe komuniteteve rome.

Janë mbledhur të dhëna për 804 vendbanime rome në 584 komuna. Nga të gjitha banesat rome, vetëm 73% sish janë të kyçura në rrjetin e ujësjellësit. Gjithashtu, hulumtimi ka treguar se 45% e banesave nuk janë të kyçura fare as në rrjetin e kanalizimit, e as nuk kanë gropa septike apo pajisje shtëpiake për trajtim të ujërave të zeza. Sistemi i përdorur për mbledhjen e të dhënave mundëson gjithashtu krijimin e hartave të ndryshme, siç është harta e paraqitur më lart.



- Shqipëria – "Monitorimi i zbatimit të Strategjisë kombëtare për përfshirjen e romëve" – prezantuar nga Jaroslav Kling, Qendra Rajonale e UNDP-së në Bratisllavë

Shqipëria është në proces të ngritjes së një sistemi për monitorim të zbatimit të Strategjisë kombëtare për përfshirjen e romëve. Si hap i parë në këtë proces ka qenë rënia dakord rreth treguesve që do të përdoren, gjë që tashmë është bërë në bashkëpunim me OJQ-të, akademinë/institutet hulumtuese dhe përfaqësues të qeverisë. Është thelbësore që në këtë fazë të përfshihen të gjitha palët e interesit, për të siguruar mbledhje dhe raportim të rregullt të të dhënave përkatëse. Sistemi është bartur më pas në internet dhe do t'ia bëjë të mundur qeverisë që të

REPUBLIC OF ALBANIA
Ministry of Labour, Social Affairs and Equal Opportunities

Progress Report

Decade of Roma Action Plan
2010 - 2015

Code	Name	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Ministry of Education	1.1.1 Statistics that provide data on education situation of Roma community, developed	0	0	0	0	0	0
	1.2.1.1 Number of teachers/specialists trained to counsel Roma parents	132	30	0	0	0	0
	1.2.1.2 Number of teachers/specialists trained to counsel Roma parents female	0	0	0	0	0	0
	1.2.1.3 Number of teachers/specialists trained to counsel Roma parents male	0	0	0	0	0	0
	1.2.2 Number of awareness raising campaigns run by the Regional Education Directorates with Roma parents	54	0	0	0	0	0
	1.2.3.1 Number of Roma parents participating awareness raising campaigns run by the Regional Education Directorates	401	0	0	0	0	0
	1.2.3.2 Number of Roma parents participating awareness raising campaigns run by the Regional Education Directorates female	0	0	0	0	0	0
	1.2.3.3 Number of Roma parents participating awareness raising campaigns run by the Regional Education Directorates male	0	0	0	0	0	0
	1.3.1.1 Number of Roma children enrolled in kindergartens	659	650	660	780	841	890
	1.3.1.2 Number of Roma children enrolled in kindergartens female	0	0	0	0	0	0
	1.3.1.3 Number of Roma children enrolled in kindergartens male	0	0	0	0	0	0
	1.3.2.1 Number of Roma children enrolled in the preparatory classes in kindergarten	36	0	0	0	0	0
	1.3.2.2 Number of Roma children enrolled in the preparatory classes in kindergarten female	0	0	0	0	0	0

përgatisë raporte periodike rreth zbatimit të Strategjisë, si dhe të identifikojë boshllëqet ku nevojitet veprim më intensiv.

- Bosnja dhe Hercegovina – *"Mekanizmi i mbledhjes së të dhënave"* – prezantuar nga Zoran Husanović, Udhëheqës i Departamentit të TI-së, Ministria e të Drejtave të Njeriut dhe Refugjatëve

Ministria për të Drejta të Njeriut dhe Refugjatë ka ngritur një sistem online për mbledhjen e informatave rreth komuniteteve romë nëpër lokacione të ndryshme anembanë vendit (tani për tani, fokusi është vënë mbi komunat me popullsi më të madhe romë). Informatat sigurohen nga Qendrat për Punë Sociale, punonjësit e të cilave janë trajnuar për këtë punë kur sistemi ishte ende në zhvillim e sipër. Informatat përfshijnë të dhëna personale për përfituesit individualë, por mund të nxirren gjithashtu raporte të përgjithësuara që tregojnë trendet. Ministria regjistron të dhëna bazike për çdo projekt të financuar nga buxheti publik, dhe Qendrat për Punë Sociale i propozojnë përfituesit prej regjistrave të tyre (karakteristikat kryesore të regjistruara kanë përfshirë moshën, gjininë, numrin e fëmijëve etj.) Ministria i miraton më pas përfituesit e propozuar, por ajo gjithashtu mund t'i refuzojë nëse konstaton se nuk janë përmbushur kriteret. Kjo i mundëson Ministrisë që të sigurojë bashkërendim më të mirë të projekteve që kanë të bëjnë me romët dhe të parandalojë përfitimin e dyfishtë, kur personi mund të aplikojë për të njëjtën ndihmë në vende të ndryshme. Tani Ministria po ngritë vetëdijen rreth këtij sistemi dhe po punon me OJQ-të për t'i regjistruar projektet e tyre në sistem (aktualisht, kjo është opsionale).

ID	Ime (Roditelj) Prezime	DID	Datum rođenja	Adresa
13528	Ar... (Elvir) Musić	19156	30.10.1997	BIH 26
13274	Ar... (Med) Tahirović	19064	1.3.2003	Matnička 17, B...ša
13523	Ar... (Edž) Musić	19155	28.6.1955	Mar Kulina... 2
13516	Ar... (him) ukalić	19153	5.2.1981	op Banloz
13525	Ar... (m) sić	19155	28.9.1981	L...var Kulina...ana 2
5602	Ar... (Fe) Š...lić	19118	22.8.2008	Bar...
15386	Ad... (Me) jeferović	19129	10.2.2005	... P... 13
13233	Ad... (ner) Osmanović	18943	4.7.2006	... P...vići
5418	Ar... (Ras) valić	18997	25.5.1992	Z... C...+a
16313	Ar... (Ja) ...Mrgić	18938	10.11.1984	Ve...udije Građeše 21

- Serbia – *"Pjesëmarrja e romëve në regjistrimin e popullsisë në vitin 2011"* – prezantuar nga Jasna Millanković, Udhëheqëse e Grupit për përgatitjet për regjistrim të popullsisë, Departamenti për Regjistrim të Popullsisë, Enti i Statistikave të Republikës së Serbisë

Aktivitetet përgatitore për regjistrimin e popullsisë janë kryer nga Enti i Statistikave në bashkëpunim me Ministrinë për të Drejtat e Njeriut dhe të Pakicave, Këshillin Kombëtar të Pakicës Kombëtare Rome dhe Zyrën për Përfshirjen e Romëve të Vojvodinës. Enti i Statistikave ka trajnuar 80 romë për pjesëmarrje aktive në përgatitjet organizative dhe punën në terren gjatë regjistrimit. Një pilot regjistrim është kryer në 23 komuna, ku, sipas rezultateve të regjistrimit të vitit 2002, popullata romë ka qenë në epërsi numerike më të madhe. Kur erdhi koha për regjistrimin e vitit 2011, Enti i Statistikave punësoi rreth 150 koordinatore dhe 550 regjistruar të tjerë për të punuar në 638 zonat e regjistrimit në të cilat shtrihen vendbanimet romë (në 150 komuna). Përveç tjerash, këta punonjës është dashur të përshkruajnë vendndodhjen e vendbanimeve të romëve, disa prej të cilave janë ndërtuar ilegalisht dhe nuk kanë adresë të rregullt. Tërë kjo punë u përcoll me një fushatë promovuese dhe numri i romëve që u regjistruan u ngrit për gati 40,000 njerëz më shumë në krahasim me regjistrimin e vitit 2002.

2. Përvoja në mbledhjen e të dhënave nga pushteti lokal

- Serbia – *"Monitorimi i zbatimit të Strategjisë së përfshirjes së romëve në qytetin e Krushevcit"* – prezantuar nga Zorana Pavloviq, Koordinatorë për çështjet e romëve

Qyteti i Krushevcit ka mbi 3,500 banorë romë të cilët jetojnë në 16 vendbanime me kushte të ndryshme infrastrukturore. Në vitin 2009, qyteti miratoi një Strategji për përmirësimin e pozitës së romëve për periudhën 2009-2011 (që më pas u zgjat deri në vitin 2014). Qyteti ka themeluar një Këshill që udhëheq me zbatimin e Strategjisë, si dhe disa komisione teknike që mbikëqyrin fusha të veçanta. Çdo vit ndahen fonde nga buxheti i qytetit për masa të ndryshme të përcaktuara në Strategjinë dhe bëhen ftesa publike për aplikim për projekte. Ndonëse shkalla e realizimit të fondeve të zotuar është rreth 50%, janë zbatuar shumë aktivitete të vlefshme sikurse përpilimi i planit kadastral dhe topografik për vendbanimet romë, realizimi i aktiviteteve të ndryshme kulturore etj. Këshilli dhe komisionet e tij u dorëzojnë raporte të rregullta Këshillit Bashkiak dhe Kryetarit rreth përparimit të bërë përkitazi me këto aktivitete.

- Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë – *"Përpilimi i hartës së vendbanimeve romë në Shtip dhe Prilep"* – prezantuar nga Tatjana Periq, konsulente

Qendrat informative të romëve (QIR) në komunat e Shtipit dhe Prilepit kanë kryer një sondazh që përqendrohet në gjendjen e strehimit të romëve, si dhe disa aspekte të tjera të jetesës së tyre (regjistrimi civil, shkollimi etj.). Përmes këtij aktiviteti, QIR-të i kanë fuqizuar kapacitetet e tyre për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave. Në sajë të sondazhit, është konstatuar, në mes tjerash, se vetëm rreth 40% e shtëpive të romëve furnizohen me ujë të pijshëm dhe përafërsisht 30% kanë tualet. Pak më shumë se gjysma e romëve kanë dëshmi ligjore për pronësinë mbi shtëpitë e tyre - dhe shumica e banesave janë në pronësi të burrave romë (82% në Prilep, 75% në Shtip). QIR-të do t'i shfrytëzojnë këto të dhëna për të avokuar për masa të reja në komunat e tyre gjegjëse dhe për të hartuar projekte të reja në këtë fushë.

3. Studimet e hendekut mes politikave dhe praktikës të kryera nga hulumtues romë me përkrahjen e projektit PMIR

BPRI ka përkrahur hulumtues romë nga Ballkani Perëndimor në kryerjen e studimeve të hendekut mes politikave dhe praktikës. Hulumtuesit romë kanë përzgjedhur temën dhe vendbanimin për hulumtim, ndërsa kanë marrë këshilla metodologjike nga këshilltarët e hulumtimit (pjesëtarë nga akademja dhe institutet hulumtuese në rajon). Deri më sot janë kryer katër studime:

- *"Shërbimet shëndetësore për komunitetet romë në komunën e Shushicës, Vlorë"* (Shqipëri), shkruar nga Bledar Taho me mbështetje këshillimore nga Alban Nelaj

Studimi ka gjetur se 79% e 175 romëve të anketuar në komunën e Shushicës, që ndodhet në jugperëndim të Shqipërisë, nuk kanë librezë shëndetësore dhe kjo është identifikuar si pengesë kryesore për qasjen e tyre në shërbime shëndetësore, njëherazi me ndikim negativ në shëndetin e tyre. Raporti gjithashtu ofron një pasqyrë të kushteve të jetesës së romëve në Shushicë, ku 77% të anketuarve e kanë vlerësuar gjendjen e shërbimeve publike sanitare në lagjen e tyre si të keqe apo shumë të keqe. Tre të katërtat e të anketuarve kanë qenë të pakënaqur me shërbimet e mbledhjes të mbeturinave.

Raporti është në dispozicion në gjuhën angleze, shqipe dhe romë në adresën e internetit http://www.bpri-odhr.org/single-news/items/PPGS_Albania.html.

- *"Posedimi i dokumenteve të identitetit, si kërkesë e integritit social të romëve të rinj në vendbanimin "Veliki Rit" në Novi Sad"* (Serbi) shkruar nga Marina Simeunovic me mbështetje këshillimore nga Svetlana Djurdjevic-Lukic

Studimi trajton problemet e regjistrimit civil, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit që ky problem ka tek të rinjtë të cilët janë në kërkim të ndonjë pune, mendojnë të krijojnë familje apo të kenë qasje në shërbime. Ky studim rekomandon që autoritetet shtetërore t'i thjeshtojnë procedurat e regjistrimit dhe të bëjnë përpjekje më të mëdha për vetëdijësimin e zyrtarëve të regjistrimit civil përkitazi me nevojat dhe shqetësimet e romëve. Raporti vë në dukje se digjitalizimi i të dhënave në zyrat e regjistrimit civil mund ta përshpejtojë procedurën për marrjen e dokumenteve të identitetit dhe t'i ulë shpenzimet.

Raporti është në dispozicion në gjuhën angleze, shqipe dhe romë në adresën e internetit http://www.bpri-odhr.org/single-news/items/From_exclusion_to_inclusion_through_identification.html.

- "Qasja e komuniteteve të riatdhesuara në Fushë Kosovë/Kosovo Polje në banim dhe shërbime publike", nga Muhamet Arifi, hulumtues, dhe Adrian Zeqiri, këshilltar për hulumtim

Shumë romë të cilët kthehen në Kosovë* nuk mund të kthehen në shtëpitë e tyre të mëparshme, ose nuk u sigurohet banesë adekuate, dhe kjo po e kufizon efektshmërinë e politikave të qeverisë për riatdhesim. Gjysma e 61 romëve të riatdhesuar të cilët janë anketuar në kuadër të studimit kanë thënë se nuk kanë mundur të kthehen në zonat ku kanë jetuar më parë para se të largoheshin nga vendi. Madje, edhe për ata romë që mundën të ktheheshin përsëri në zonat ku kishin jetuar më parë, përvoja e kthimit në shtëpi ka qenë e vështirë. Shumë nuk kanë mundur ta përballojnë qiranë për këto prona. Të tjerët janë detyruar të jetojnë në shtëpi të zbrazëta që janë braktisur nga të tjerë që kishin braktisur Kosovën, duke qenë të detyruar që të zhvendosen përsëri diku tjetër pas kthimit të pronarëve të këtyre pronave.

Raporti është në dispozicion në gjuhën angleze, shqipe dhe rome në adresën e internetit http://www.bpri-odhr.org/single-news/items/Repatriation_before_reintegration.html.

- *Regjistrimi dhe posedimi i dokumenteve të identifikimit personal si parakushte për arsimimin më të mirë të popullsisë rome, nëpërmjet rasteve studimore të vendbanimeve "Topaana" dhe "Sredorek" në Shkup dhe Kumanovë*, shkruar nga Ajnur Sulejman me mbështetje këshillimore të Vladimir Misev

Studimi ka gjetur se mungesa e parave është pengesë kyçe që i ndalon romët të pajisen me dokumente personale të identifikimit dhe, nga ana tjetër, kjo e pengon integrimin e tyre në shoqëri. Një e treta e të anketuarve kanë pasur probleme me nxjerrjen e dokumenteve të identifikimit, dhe 95 për qind e tyre kanë thënë se janë shumë të varfër për të aplikuar për dokumente identifikimi. Tridhjetë e gjashtë të anketuar kanë thënë se ndihma e pamjaftueshme nga autoritetet në procedurën e aplikimit gjithashtu paraqet pengesë për ata dhe shumë romë të tjerë për t'u pajisur me dokumente personale të identifikimit.

Raporti është në dispozicion në gjuhën angleze, maqedone dhe rome në adresën e internetit http://www.bpri-odhr.org/single-news/items/MAC_Policy_Practice_gap_study.html.

Vizitat në komunat e Shtipit dhe Prilepit

Shtipi ndodhet në pjesën lindore të vendit dhe ka gjithsej 47.796 banorë. Sipas regjistrimit të fundit në vitin 2002, komuniteti rom në Shtip zyrtarisht kap numrin 2.295 banorë, ose 4.59% të popullsisë së përgjithshme, megjithëse aktivistët lokalë besojnë se numri i vërtetë i romëve lokalë është rreth 5,000. Shumica e romëve të Shtipit jetojnë dy vendbanime – rrugët "Radanski Pat" dhe "Kosovska" që gjenden në periferi të qytetit. Banesat janë kombinim i shtëpive me materiale të forta dhe kasolleve, dhe infrastruktura bazike është në dispozicion aty-këtu. Për t'i adresuar nevojat e komunitetit lokal rom, komuna e Shtipit ka të punësuar dy zyrtarë për komunitete të cilët janë të përkatësisë etnike rome dhe ka ofruar hapësirë zyre për Qendrën Informativë të Romëve (QIR). Planet e para lokale të veprimit për romët janë hartuar për periudhën 2006-2010. Tani ato po rishikohen dhe përditësohen për periudhën e ardhshme katërvjeçare.

Komuna e Prilepit ndodhet në pjesën qendrore të vendit dhe popullata rome e saj jeton kryesisht në tre vendbanime të mëdha: "Trizla 1" e "Trizla 2" dhe "Tri Bagremi". Dy të parat kanë një kombinim të kushteve të ndryshme infrastrukturore dhe llojeve të strehimit, duke filluar nga kasollet e rëndomta deri të shtëpitë moderne të ndërtuara me materiale të forta me të gjitha kushtet e nevojshme. Në anën tjetër, "Tri Bagremi" është vendbanim më i vogël dhe me kushte të vështira jetese. Sipas Entit Shtetëror të Statistikave, në Prilep jetojnë 4333 banorë me prejardhje rome, por sipas përlogaritjeve jozyrtare këta numra sillen në diku afërsisht 6-8,000 banorë, të përqendruar kryesisht në vendbanimin "Trizla". Përkundër faktit se shumica e romëve në Prilep kanë sigurim shëndetësor, me përjashtim të atyre që nuk kanë letërnjoftime dhe situata e të cilëve aktualisht po shqyrtohet nga QIR-të, gjendja e keqe shëndetësore e shumë romëve lokalë pasqyron në masë të madhe statusin e tyre ekonomik dhe kushtet joadekuate të tyre të banimit. Planet lokale të veprimit për romët ose janë miratuar ose janë në proces të miratimit. Këshilli bashkiak ka një anëtar rom, dhe një anëtar i personelit të administratës është gjithashtu rom dhe shërben si person për kontakt për çështje rome.

Ajo që të çudit në këto dy komuna është që pas emërimit të koordinatorit për romët në administratën komunale gjërat kanë filluar të shkojnë për së miri në lagjet e romëve. Zyrtarët komunalë për romët (dhe/ose çështje ndëretnike) punojnë së bashku me personelin e Qendrave informative të romëve (QIR) dhe tani në Prilep ata kanë projekte shumëmilionëshe për përmirësim të infrastrukturës në lagjet e

* Ky përcaktim është pa paragjykim për pozitën apo statusin, dhe është në vijë me RKS KB 12/44 dhe mendimin e GJND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

romëve me sistem të ri të ujësjellësit, sisteme të reja të drenazhimit dhe kanalizimit, rrugë të asfaltuara dhe ndriçim të rrugëve. Projekti PMIR ka siguruar vetëm një grant të vogël për ndriçim të rrugëve, por koordinatori për romët e ka vlerësuar shkëmbimin me akterë të tjerë rajonalë dhe hulumtimin e kryer si përkrahje përmbajtësore dhe me krenari i ka ndarë arritjet me pjesëmarrësit. Për më tepër, personeli i QIR-ve në këto dy komuna nuk i ndihmon vetëm romëve, por edhe popullatës shumicë, duke e zvogëluar në këtë mënyrë hendekun mes pushtetit lokal dhe qytetarëve.

Përfundimet dhe rekomandimet

Pjesëmarrësit i kanë diskutuar praktikën e tyre të tanishme në mbledhjen e të dhënave dhe monitorimin e politikave, dhe kanë nxjerrë rekomandimet e mëposhtme:

- Aktivistët dhe studentët e kualifikuar romë duhet të përfshihen në mbledhjen dhe analizën e të dhënave në nivel lokal dhe kombëtar. Programet në këtë fushë duhet të zgjerohen më tej meqë janë thelbësore për zhvillim të kapaciteteve të hulumtuesve romë dhe për të siguruar pjesëmarrjen e tyre në hartimin dhe zbatimin e studimeve të përfshirjes sociale, të regjistrimit të popullsisë dhe nismave të tjera. Çdo komunë mund t'i identifikojë nevojat e komunitetit lokal rom duke bashkëpunuar me OJQ-të rome dhe, po të jetë e nevojshme, duke u ndihmuar atyre që t'i zhvillojnë kapacitetet për mbledhjen e të dhënave.
- Pjesëmarrja e romëve lokalë është thelbësore për mbledhje të të dhënave të sakta, sepse shpesh ka mosbesim ndaj anketuesve të jashtëm. Pyetësorët duhet të përkthehen në gjuhën rome. Gratë rome duke të inkurajohen në veçanti për të marrë pjesë në projektet e hulumtimit dhe për të vijuar studime universitare.
- Të dhënat jo vetëm që duhet të mbledhen, por edhe të shfrytëzohen nga pushteti lokal dhe qendror për të formuluar masa të reja, për t'iu përgjigjur nevojave lokale dhe për të publikuar raporte periodike për rezultatet.
- Temat relativisht tabu, siç janë martesat e hershme dhe të detyruara, duhet të shtjellohen përmes projekteve kërkimore të reja për të rritur vetëdijen rreth këtyre çështjeve.
- Të dhënat e mbledhura në nivel lokal dhe kombëtar duhet të shfrytëzohen për të fituar një pasqyrë më të plotë të problemeve me të cilat përballen romët. Sistemet elektronike duhet të studiohen me qëllim të lidhjes mes institucioneve të ndryshme dhe ndërlihdjes së këtyre të dhënave me monitorimin e zbatimit të politikave.
- Bashkëpunimi ndërsektorial duhet të përmirësohet, sepse ofruesit e kujdesit shëndetësor, shkollat, policia dhe akterët e tjerë duhet të shkëmbejnë të dhëna për të promovuar integrimin e romëve në mënyrë më efektive. Disa çështje, siç është kërkimi i lëmshës në rrugë, mund të adresohen vetëm bashkërisht dhe nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm.
- Të dhënat e mbledhura në terren duhet të përdoren si bazë për hartimin e planeve të veprimit lokal për integrimin e romëve dhe iniciimin e aktiviteteve konkrete për rregullimin e situatës.